

Rrjeti për Ruajtjen e Cetaceve dhe Breshkave Detare në Adriatik

Projekti NETCET financohet nga Programi IPA Adriatik CBC dhe përfshihet në Prioritetin 2 “Burimet Natyrore dhe Kulturore dhe Parandalimi i Rreziqeve”.

Qëllimi kryesor i këtij programi bashkëpunimi ndërkuftar është forcimi i kapaciteteve për një zhvillim të qëndrueshëm të rajonit të Adriatikut, nëpërmjet një strategjie të përbashkët aktivitetesh midis vendeve partnere të këtij rajoni.

Faqja ëeb e projektit: www.adriaticpacbc.org

Përmbajtja

1. Konferenca Finale
2. Rezultatet e NETCET
3. Takim konsultativ në Itali
4. Rjeti i qyteteve NETCET

1. Konferenca Finale: një ditë e gjysëm për t’u mbajtur mend



Ashtu si shumë projekte Evropiane, NETCET ka organizuar konferencën e tij finale. Ato çfarë mund të kujtojnë më tepër pjesmarrësit janë rezultatet e shumta të prezantuara, cilësia e prezantimeve, atmosfera pasionante e prezantimeve plenare dhe hapat konkrete pozitive drejt temës që mbledhi mbi 100 pjesmarrës në sallë: mbrojtja e cetaceve dhe breshkave detare në Detin Adriatik.

Pas fjalës së mirëseardhejs nga Bashkia e Venecias dhe Autoriteti Menaxhues i Programit IPA Adriatic CBC, **sesioni i parë** iu dedikua tërësisht **ilustrimit të rezultateve të arritura nga projekti**, të tilla si

standartizimi i përbashkët i njohurive shkencore dhe bashkëpunimi efikas ndërmjet organizatave të përfshira në mbrojtjen e cetaceve dhe breshkave detare në Adriatik, rritja e kapacitetit institucional për mbrojtjen e cetaceve dhe breshkave detare në vendet partnere, rritja e njohurive mbi popullatat e cetaceve dhe breshkave detare të Adriatikut, hot-spotet dhe kërcënimet kryesore ndaj tyre, rritja e kapaciteteve teknike për shërimin e breshkave detare në Adriatik dhe trajtimi efikas i breshkave të plagosura, ose të ngecura në breg

dhe shtim të informacionit në dispozicion të grupeve të interesit në qendra të posaçme. Projekti gjithashtu ka ndikuar në rritjen e ndërgjegjes së komuniteteve bregdetare mbi praninë dhe nevojat e mbrojtjes së këtyre llojeve, të procedurave të trajtimit të tyre nga peshkatarët, përmirësimin e mbrojtjes dhe menaxhimit të këtyre llojeve dhe habitateve të tyre në Adriatik nëpërmjet bashkëpunimit efikas rajonal dhe duke nxitur ndjenjën e pronësisë dhe krenarisë tek komuniteti lokal mbi vlerat e trashëgimisë në rajonin e Adriatikut.

Këto rezultate u diskutuan dhe u trajtuan edhe në këndvështrimin e një perspektive globale në diskutimet e bëra nga tre ekspertë me famë botërore, si Roderic Mast, President i Shoqatës Oqeanike, bashkëdrejtues i Grupit të Ekspertëve të Breshkave Detare të IUCN, SHBA, Randall Reeves, Drejtues i Grupit të Ekspertëve të Cetaceve të IUCN, Kanada dhe Giuseppe Notarbartolo di Sciara, President i Institutit Kërkimor Tethys dhe bashkëdrejtues i Task Forcës së IUCN për Zonat e Mbrojtura të Gjitarëve Detarë, Itali.

Këto ekspertë sollën përvojat dhe kontributet e tyre mbi çështje të ruajtjes së biodiversitetit detar, duke paraqitur diskutime të një cilësie të lartë dhe duke frymëzuar të gjithë pjesmarrësit e fushave të ndryshme: studiues, ekspertë, politik-bërës, përfaqësues të administratës lokale dhe rajonale.

Dita e konferencës vazhdoi me një sesion të pazakonshëm “të mësojmë nga njeri-tjetri”, ku ishin ftuar 7 projekte “simotra” për të paraqitur rezultatet e tyre dhe për të vënë në dukje lidhjet e tyre me rezultatet e NETCET. Kjo u vlerësua veçanërisht si një ushtrim i vlefshëm për të patur një panoramë të plotë mbi atë çfarë bëhet në projekte të ngjashme, për të rritur efikasitetin e tyre nga ndarja e përvojave me njëri-tjetrin dhe për t'i përdorur këto përvoja në projekte të reja të mundëshme. Kjo ditë kulmoi me prezantimin e bërë nga Paola di Salvatore, Programi IPA Adriatic CBC, e cila dha konsideratat e saj mbi projektin NETCET dhe vizionin mbi përdorimin e vlerave të krijuara nga rezultatet e këtij projekti.

Dita e dytë, dedikuar prezantimeve të Strategjive të Perbashkëta dhe Planeve Kombëtare të Veprimit për ruajtjen e breshkave detare dhe cetaceve në secilin nga vendet e Adriatikut, u hap nga **Vedran Nikolić, specialist i politikave në njësinë e Natyrës të Komisionit Europian, Divizioni i Mjedisit**, i cili dha informacione me vlerë mbi Programin e 7-të të Veprimit Mjedisor dhe Direktivës së Habiteteve të BE. **Sesioni i fundit iu dedikua qyteteve dhe rajoneve të përfshira në ruajtjen e Detit Adriatik.** U bë paraqitja e rrjetit të qyteteve NETCET të Adriatikut me 30 qytetet e tij, si dhe i vazhdimësisë së tij të siguar nga Bashkia e Numanas (Itali). Rajonet e asociuara të NETCET dhe këshilltari për peshkimin detar i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Malit të Zi shpjeguan strategjitë dhe politikat e tyre për mbrojtjen e breshkave detare dhe cetaceve. Përfshirja e rajoneve të Adriatikut dhe Rrjetit të qyteteve NETCET ka siguruar kontributin e tyre institucional për zbatimin e strategjisë dhe bashkërendimin rajonal në Adriatik. Konferenca finale u mbyll me dëshirën dhe shpresën për projekte dhe bashkëpunime të tjera në të ardhmen.

Prezantimet dhe video nga konferenca gjenden në adresat e mëposhtme:

http://netcet.eu/2013-01-04-21-37-20/item/129-final_conference_video

http://netcet.eu/2013-01-04-21-37-20/item/128-final_conference_presentations

Carole Maignan – Menaxhere e Projektit NETCET

2. Rezultatet e NETCET

Rezultatet nga aktivitetet e monitorimit në kuadër të NETCET tregojnë se Deti Adriatik është më i rëndësishëm për cetacetë dhe breshkat detare se nga sa mendohej më përpara.

Vrojtimi ajror (mbi 14,000 km në 100 orë fluturime) ka siguruar informacione mbi përdorimin e Detit Adriatik nga këto lloje dhe ka konfirmuar se Adriatiku Verior ka rëndësi të veçantë për breshkat detare. Kjo është konfirmuar nga **gjurmimet satelitore të 20 juvenilëve të breshkës së zakonshme të detit (JLT) dhe 3 juvenilëve të breshkës së gjelbër (GT)**, të cilat provuan se JLT qëndron në Adriatik pavarësisht ndryshimeve stinore, duke u varur ndjeshëm nga zonat e ushqimit në Adriatikon Verior, ndërsa GT zhvendoset drejt ujrave më të ngrohtë në Adriatikon Jugor gjatë dimrit. **Lëvizjet e breshkave të NETCET mund të ndiqen online në adresën e mëposhtme:**

http://www.seaturtle.org/tracking/?project_id=1021



© Tilen Genov

Vrojtimi ajror tregoi gjithashtu për një diversitet të lartë të cetaceve në rajon, me një numër të madh të delfinëve me vija dhe prani të balenës me sqep të Kuvierit në Jug të Detit Adriatik. Popullatat e delfinit hundëshishe janë monitoruar përmes studimeve me fotografime të vazhdueshme (mbi 500 orë vrojtime me skaf) në të gjithë vendet e Adriatikut. Analizat tregojnë që secila popullatë është unike, me këmbime të vogla me njëra-tjetrën.

Janë ekzaminuar kafshët e dala në breg dhe janë analizuar shkaqet e ngordhjeve të tyre, si në rastet e daljeve individuale, ashtu edhe ato masive.

Gjatë muajve të fundit të projektit dhe duke shfrytëzuar rezultatet e të gjithë aktivitetëve të

mëparshme të tij, **partnerët e NETCET kanë përcaktuar nevojat për ruajtjen e cetaceve dhe breshkave detare në të ardhmen në Adriatik, duke zhvilluar strategji të përshtatshme për dekadën e ardhëshme (2016 – 2025)**. Qëllimi i këtyre dokumenteve është që të transformojë burimet ekzistuese në masa konkrete veprimi dhe për të përcaktuar një vizion të përbashkët: “Deti Adriatik, si një vend i sigurtë i bashkë-ekzistencës së cetaceve, breshkave detare dhe njeriut”.

Strategjitë e Përbashkëta për Mbrojtjen e Cetaceve dhe Breshkave Detare, në formën e dy broshurave, gjenden online në adresën e mëposhtme:

http://netcet.eu/dissemination/item/124-common_strategies_conservation_stct



Gjithashtu, këto strategji duhen përdorur si orientime për zhvillimin e Planeve Kombëtare të Veprimit (PKV) në secilin prej vendeve të Adriatikut. Partnerët kanë zhvilluar tashmë takime konsultative në vendet e tyre (Itali, Slloveni, Kroaci, Mali i Zi dhe Shqipëri) me Ministritë dhe të gjithë grupet e interesit të lidhur me cetacetë dhe breshkat detare, në mënyrë që të përcaktojnë elementët kyç për përmirësimin e PKV-ve ekzistuese, hartojnë PKV të reja dhe të sigurohet miratimi zyrtar nga ministritë përkatëse për zbatimin e këtyre planeve.

Një nga iniciativat e para të NETCET ishte krijimi i një **rrjeti shkencor** me ekspertë nga fusha të ndryshme të kërkimit në rajonin e Adriatikut, për këmbimin e njohurive dhe përvojave, si dhe për zhvillimin e databazave për raportimin e llojeve të dala në breg.

Ky rrjet gjithashtu ndihmon studiuesit për vëzhgimin dhe analizimin e rasteve të ngordhjeve të pazakonta të kafshëve në Adriatik dhe për të

zbatuar protokolle dhe strategji të përbashkëta për përbalimin e emergjencave të mundëshme në të ardhmen

NETCET ka krijuar gjithashtu një **Task Forcë për Emergjencat në Adriatik**. Kjo përbëhet nga grup ekspertësh (biologë dhe veterinerë) të aspekteve shkencore të lidhura me cetacetë dhe breshkat detare, si sjellja, fiziologjia, shpëtimi, trajtimi dhe ndërhyrjet në raste të aksidenteve mjedisore, ngordhjeve të pazakonta, ose daljes masive të kafshëve në brigje.

Ky grup vepron si një ekip ekspertësh për mbështetjen e autoriteteve përkatëse kombëtare. Aksidenti i parë gjatë periudhës së NETCET ndodhi në Shtator 2014 në Vasto, Itali, ku shtatë balena kashalot dolën në breg. Mbi tetëdhjetë anëtarë të task forcës punuan së bashku për të shpëtuar këto kafshë, duke i kthyer në det. Paralelisht, 133 veterinerë kanë marrë pjesë në programet e trainimit mbi aspektet veterinerë dhe menaxhimin e situatave të daljeve në breg të cetaceve dhe breshkave detare.

Në adresën e mëposhtme do të gjeni propozimin mbi **Task Forcën për Emergjencat në Adriatik**: <http://www.netcet.eu/dissemination/item/130-the-adriatic-emergency-task-force-proposal>

Janë prodhuar dhe shpërndarë protokolle standarte për egzaminimet pas ngordhjes dhe ato fizike të cetaceve dhe breshkave detare, të cilat gjenden në adresën: <http://www.netcet.eu/dissemination/item/131-standard-protocols-for-post-mortem-and-physical-examination-of-cst>

Është prodhuar dhe shpërndarë literaturë reference për specialistët dhe të interesuarit që punojnë me cetacetë dhe breshkat detare. Është botuar edhe një libër praktik mbi Trajtimin e Cetaceve të Dala në Breg, publikuar nga Sandro Mazzariol, Bruno Cozzi dhe Cinzia Centellegh, të cilin mund ta gjeni në adresën e mëposhtme: <http://www.netcet.eu/dissemination/item/132-handbook-for-cetaceans%E2%80%99-strandings>

Me mbështetjen e projektit janë ngritur 3 **qendra emergjence dhe reabilitimi për breshkat detare**, në Shqipëri, Kroaci dhe Itali, si dhe është përmirësuar infrastruktura ekzistuese e 13 qendrave të tjera në Itali dhe Kroaci. Në plazhin e Numanas, Itali, është ndërtuar një “pishinë” reabilitimi në ujrat detare.

Fushatat ndërgjegjësuere të NETCET kanë arritur objektivat e tyre sasiore dhe cilësore përse i përket grupeve të adresuara:

- 100 aktivitete publike për lëshimin e breshkave në det, me pjesëmarrjen e mbi 10,000 njerëzve;
- shpërndarje informacioni nga mass-media për rreth 2 milion banorë mbi mbrojtjen e cetaceve dhe breshkave detare;
- ndërgjegjësim i mbi 700 peshkatarëve për ndikimet mjedisore që ato shkaktojnë ndaj breshkave detare, si dhe mbi procedurat që duhen ndjekur për shpëtimin e kafshëve të kapura aksidentalisht në mjetet e tyre të peshkimit;
- mbi 4,000 pronarë mjetesh lundrimi janë informuar mbi mënyrat e lundrimit dhe sjelljes pranë cetaceve dhe breshkave detare, me qëllim zvogëlimin e shetësimeve ndaj tyre;
- me mbi 3,000 nxënës shkollash në zonat bregdetare të Adriatikut janë kryer aktivitete ndërgjegjësuere duke përdorur mjete didaktike të posaçme.

Në adresën e mëposhtme do të gjeni mjetet edukative të NETCET për nxënësit e shkollave dhe mësuesit:



<http://www.netcet.eu/dissemination/item/133-educational-kit-materials>

3. Takim konsultativ në Itali: “Qytetet dhe rajonet, së bashku për mbrojtjen e cetaceve dhe breshkave detare”

Me 8 Tetor 2015 u organizua një takim konsultativ me qytetet italiane të Rrjetit të Qyteteve NETCET dhe rajoneve italiane të Adriatikut. Takimi u zhvillua në Venecia, në Kështjellën Porta Nuova, në Arsenalin e Venecias. Në takim kishte pjesmarrës edhe nga institucionet dhe organizatat lokale që punojnë me cetacetë dhe breshkat detare.

Pas hapjes së takimit nga Massimiliano De Martin, zëvendës kryetar i Bashkisë së Venecias për çështjet e mjedisit, menaxherja e Projektit NETCET, Carole Maignan, paraqiti çështjet kryesore të projektit dhe objektivat e këtij takimi. Sesioni i parë filloi me ekspertin **Caterina Fortuna**, nga Instituti për Kërkime dhe Mbrojtjen e Mjedisit, e cila paraqiti **rezultatet e aktiviteteve të lidhura me monitorimin e cetaceve dhe breshkave detare në Adriatik, si dhe kuadrin ligjor për mbrojtjen e këtyre llojeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ajo paraqiti gjithashtu draftin e Planit Kombëtar të Veprimit për mbrojtjen e cetaceve dhe breshkave detare, duke ftuar pjesmarrësit për komente. Ky draft do t'i paraqitet**



Ministrive përkatëse pasi të diskutohet dhe miratohet nga autoritetet lokale dhe rajonale.

Ky plan ka dy objektiva kryesore, secili i zbërthyer në nën-objektiva dhe aktivitetet për t'u realizuar, së bashku me përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësiave për zbatimin e tij. Pas këtij takimi, Bashkia e Venecias i dërgoi draftin e planit të gjithë pjesmarrësve për të filluar procesin e konsultimit.

Në vazhdim të takimit, Sandro Mazzariol, nga Universiteti i Padovas, bëri një përshkrim të **menaxhimit të situatave të daljeve në breg të cetaceve dhe breshkave detare, duke dhënë shembuj mbi rolin e institucioneve, i cili në disa**

raste në të shkuarën nuk ka qenë i qartë. Rezultatet tregojnë se, në këndvështrimin shkencor, janë siguruar mjaft të dhëna, të cilat vënë në dukje rëndësinë e madhe të Adriatikut si habitat shumë i rëndësishëm për cetacetë dhe breshkat detare. Kjo është bërë e mundur jo vetëm përmes krijimit të databazave të standartizuara, por edhe përmes përcaktimit të procedurave të përbashkëta mbi mënyrat e trajtimit të kafshëve të dala në breg dhe analizimit të situatave dhe rezultateve gjatë këtyre dukurive.

Pas prezantimeve të partnerëve të NETCET, qytetet dhe rajonet pjesmarrëse bënë një paraqitje të përvojave të tyre: Sergio Ventrella nga Observatori Toskan i Biodiversitetit, paraqiti Sanktuarin Pelagos, si një përvojë e bashkëpunimit Itali, Francë dhe Monako, me pjesmarrjen e drejtpërdrejtë të qyteteve. Claudio Zabaglia, menaxher i Rajonit të Markes, paraqiti rastin e qytetit të Numanas me përvojën e tij të mirë, duke filluar me krijimin e një pishine natyrore në plazh për shërimin e breshkave detare dhe trajnimin e peshkatarëve. Ai theksoi rëndësinë e madhe të komunikimit efikas dhe përfshirjes së institucioneve vendim-marrëse, si dhe rolin e cetaceve dhe breshkave detare si elementë të rëndësishëm për identifikimin e çështjeve mjedisore, duke u fokusuar në veprime konkrete. Attilio Rinaldi, nga rrjeti rajonal i Emilia Romanjas, paraqiti rastin e rajonit të tij si një shembull i mirë për koordinimin dhe zhvillimin e qendrave të emergjencës, monitorimit, kërkimit, krijimit dhe përmirësimit të databazave, edukimit, publikimit dhe bashkëpunimit për planet e veprimit. Vincenzo Olivieri, veteriner në Qendrën e Studimit të Cetaceve, bëri një shpjegim të procedurave të trajtimit të kafshëve të dala në breg në zonën e Peskarës dhe theksoi rëndësinë e biometrisë. Dario Galloti, nga Bashkia e Venecias, paraqiti ilustrime nga menaxhimi i daljeve të kafshëve në breg përgjatë bregdetit të Venetos. Ai vuri theksin mbi rëndësinë e protokolleve dhe raporteve të qarta

dhe të standartizuara, krijimin e lehtësive për të shkuar në zonën ku është shfaqur problemi, si dhe aktivizimin 24 orësh të grupeve të punës.

Në sesionin e fundit, të moderuar nga Sauro Pari, nga Fondacioni Cetacea, u paraqit roli i Rrjetit të Qyteteve NETCET dhe 3 rajoneve të asociuara, si dhe u theksua rëndësia e përcaktimit të politikave të turizmit për qytetet bregdetare.

Për më shumë informacion mbi këtë takim, si dhe për të parë prezantimet e bëra, mund të vizitoni faqen e projektit në këtë adresë: <http://www.netcet.eu/2013-01-04-21-37-20/item/121-a-netcet-%E2%80%9Cconsultation-meeting%E2%80%9D-on-the-roles-of-italian-citiesregions-for-ctst>

4. Rrjeti i Qyteteve NETCET: Qytetet e Adriatikut, së bashku për Cetacetë dhe Breshkat Detare



Një nga objektivat e rëndësishme të Projektit NETCET është rritja dhe forcimi i bashkëpunimit midis qyteteve të përfshira në mbrojtjen e cetaceve dhe breshkave detare në të gjithë Adriatikut. Rrjeti i Qyteteve NETCET ka për qëllim rritjen e ndërgjegjes dhe rolit të qyteteve për mbrojtjen e cetaceve dhe breshkave detare. Qytetet e Adriatikut që janë pjesmarrëse në këtë Rrjet marrin përsipër të informojnë publikun mbi kërcënimet ndaj këtyre llojeve të rrezikuara dhe të zvogëlojnë shkallën e këtyre kërcënimeve (si p.sh. marrjen e masave për të zvogëluar shpejtësinë e mjeteve të lundrimit në zonat ku ka cetace dhe breshka detare, reduktimin dhe

menaxhimin e mbetjeve në det dhe bregdet, organizimin e "Ditës së Delfinëve", ose "Ditës së Breshkave Detare", etj).

Me krenari vëmë në dukje së në rrejtin tonë deri tani janë përfshirë 30 qytete: 15 qytete në Itali (Brindisi, Caorle, Chioggia, Fano, Grado, Jesolo, Manfredonia, Numana, Pedaso, Pescara, Pineto, Roseto degli Abruzzi, San Benedetto del Tronto, Trieste, Venice), 6 në Kroaci (Dubrovnik, Komiža, Mali Lošinj, Pula-Pola, Rijeka, Zadar), 4 në Malin e Zi (Budva, Kotor, Tivat, Ulcinj), 4 në Shqipëri (Durrës, Orikum, Patok-Fushë Kuqe, Vlorë) dhe 1 në Slloveni (Koper).



Duke qenë pjesë e këtij rrjeti, qytetet kanë gjithashtu mundësi të publikojnë dhe informojnë mbi aktivitetet e tyre të lidhura me cetacetë dhe breshkat detare edhe në faqen zyrtare online të Projektit NETCET dhe atë të Bashkisë së Venecias. Secili nga qytetet anëtarë të rrjetit është ftuar për të marrë pjesë në rishikimin e ardhshëm të strategjive të përbashkëta për mbrojtjen e cetaceve dhe breshkave detare, si dhe në Konferencën Finale të Projektit, të mbajtur në Venecia në Dhjetor 2015.

Qyteti i Numanas (Itali), nëpërmjet Shërbimit të Mbrojtjes Civile, është duke

Newsletter 6

zhvilluar një punë të rëndësishme mbi vrojtimin, ruajtjen dhe ndihmën ndaj kafshëve të mëdha detare, me një vëmendje të veçantë ndaj cetaceve dhe breshkave detare të Adriatikut. Kështu, përfshirja e Numanas në Rrjetin e Qyteteve NETCET ishte e pritshme, madje, për më tepër, **Numana do të jetë koordinatori i Rrjetit të Qyteteve NETCET pas përfundimit të projektit** (Janar 2016), duke garantuar vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e këtij rrjeti. Aktivitetet e këtij rrjeti përputhen plotësisht me aktivitetet e nisura që prej disa vitesh nga Numana për mbrojtjen e cetaceve dhe breshkave detare. Ekipi i NETCET i uron punë të mbarë koordinatorit të ri të rrjetit dhe është i lumtur të vazhdojë të jetë pjesë e këtij rrjeti.



The project is co-funded by the European Union,
Instrument for Pre-Accession Assistance.



Contact

City of Venice

info@netcet.eu

Economic Development, European
Policies and Strategic Plan Division

+39 041 2747826 / 7830 / 7834

San Marco 4299
30124 Venice - Italy

www.netcet.eu

www.facebook.com/NETCETproject

This Newsletter has been produced with the financial assistance of the IPA Adriatic Cross-Border Cooperation Programme. The contents of this Newsletter are the sole responsibility of the City of Venice and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the IPA Adriatic Cross-Border Cooperation Programme Authorities.